



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201302317/29

Tiranë ___/___/2015

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes" për përgatitjen dhe miratimin nga Këshilli i Ministrave të akteve nënligjore të parashikuara në nenet 4, 5 dhe 6 të këtij ligji.*

Drejtuar : Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë
Z. Edi RAMA

Tiranë

I nderuar zoti Kryeministër,

E drejta e jetës mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 21), disa akte ndërkombëtare, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB, Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e Këshillit të Evropës, si dhe Kodi Penal (nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82, 83).

Jeta është një e drejtë, atribut themelor i qënies njerëzore dhe kur kjo jetë hiqet ose merret, në çfarëdo lloj mënyre, njeriu, në të njëjtën kohë, eliminohet si mbartës të drejtash dhe detyrimesh. Jeta e njeriut duke pasur një vlerë të padiskutueshme është bërë objekt i mbrojtjes kushtetuese. Gjatë viteve të tranzicionit kjo e drejtë themelore e njeriut është çenuar seriozisht në rrethana dhe për motive nga më të ndryshme, ndër të tjera edhe për shkak të gjakmarrjes.

Gjakmarrja në Shqipëri tashmë është kthyer në një fenomen shumë shqetësues për shoqërinë tonë sepse çënon të drejtën më të rëndësishme të njeriut, të drejtën e jetës. Ndërkohë shqetësimin e këtij fenomeni dhe sidomos vitet e fundit po e vuajnë edhe disa vende të BE-së për shkak të numrit në rritje të azilkërkuesve shqiptarë të cilët pretendojnë se u rrezikohet jeta në Shqipëri për shkak të këtij fenomeni. Raporte të ndryshme në lidhje me azilkërkuesit,

nxjerrin që një ndër faktorët kryesorë në kërkesën për azil të shtetasve shqiptarë në BE ka të bëjë me gjakmarrjen.¹

Për shkak të gjakmarrjes në vendin tonë kanë lindur edhe disa pasoja të tjera negative dhe regressive sikurse mund të përmendim **ngujimin e personave pa dallim gjinie e moshe**, duke u mohuar personave të ngjuar një sërë të drejtash themelore kushtetuese, si atë të lëvizjes së lirë, të arsimimit, të punësimit, të përfitimit të kujdesit shëndetësor, të votimit, të lirisë së organizimit, të lirisë së bindjes dhe shfaqjes së saj etj.

Duke vlerësuar të drejtën e jetës si të drejtën themelore dhe më të rëndësishme të njeriut, duke pranuar edhe rrezikun që e kanos çdo ditë këtë të drejtë, Avokati i Popullit në bashkëpunim me Fondacionin “Zgjidhja e Konflikteve dhe Mosmarrëveshjeve”, më 11-12 dhjetor 2001 organizoi një Konferencë Kombëtare me temë: *“Shteti dhe Shoqëria Civile në Mbrojtje të së Drejtës së Jetës”*.

Me iniciativën dhe nxitjen e Avokatit të Popullit, Kuvendi miratoi ligjin nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”. Ky ligj ka si qëllim të organizojë dhe të koordinojë më mirë masat dhe luftën e organeve shtetërore, institucioneve shoqërore, shkencore, fetare etj., si dhe të përcaktojë një strategji afatgjate për parandalimin dhe eliminimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri.

Gjatë vitit 2012 Avokati i Popullit ka rimarrë iniciativën për sensibilizimin e institucioneve shtetërore, fetare, shoqërisë civile, medias dhe individëve në çështjen sensitive të gjakmarrjes duke organizuar disa aktivitete me këtë tematikë, bërë disa rekomandime institucioneve shtetërore dhe përgatitur e dërguar në Kuvend një Raport të Veçantë.

Gjatë shqyrtimit të këtij fenomeni konstatoam se një nga shkaqet që ka ndikuar negativisht për ekzistencën e tij është edhe moszbatimi i ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”, ndonëse ka mbi 10 vjet që ka hyrë në fuqi.

Gjithashtu kemi konstatuar se shkak për moszbatimin e këtij ligji ka qenë mosnxjerrja nga KM i tre akteve nënligjore në bazë e për zbatim të nenit 7 të ligjit.

Ne gjykuam se ishte me shumë rëndësi nxjerrja e tre akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave në bazë e për zbatim të detyrimeve ligjore që burojnë nga neni 7 ligjit të sipërcituar. Për këtë arsye me shkresën e datës 28.08.2012 i kemi rekomanduar Këshillit të Ministrave: *“Marrjen e masave të menjëhershme në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” për përgatitjen dhe nxjerrjen nga Këshilli i Ministrave të akteve nënligjore të parashikuara në nenet 4, 5 dhe 6 të këtij ligji”*.

¹ Asylum applicants from the Western Balkans comparative analysis of trends, push-pull factors and responses, EASO, 2013, faqe 43.

Ministri i Drejtësisë me shkresën e datës 20.03.2013 na informoi se rekomandimi ynë drejtuar Këshillit të Ministrave ishte mirëpritur. Në zbatim të tij ishte përgatitur dhe nxjerrë Urdhri i Kryeministrit nr. 136, datë 14.11.2012 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”, i cili kryesohet nga Zëvendësministri i Brendshëm.

Ndërkohë gjykojmë se thirrja e Këshillit Koordinues jo vetëm që është një detyrim ligjor, por do të jetë edhe një nxitje dhe mbështetje e madhe ndaj institucioneve shtetërore të përfshira drejtpërdrejt në luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes për të kryer detyrat ligjore. Për këto arsye i kemi kërkuar tre herë Presidentit të Republikës (një herë z. Topi dhe dy herë z. Nishani në datë 12.03.2013 dhe 27.11.2013) thirrjen e Këshillin Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes. Në përgjigjen e kthyer nga Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës së Republikës, ndër të tjera na bën me dije që, Presidenti nuk mund ta thërras Këshillin Koordinues nëse nuk janë miratuar 3 aktet nën-ligjore të lartpërmendura.

Meqenëse nuk kishim ndonjë informacion lidhur me hartimin apo jo të akteve nënligjore të parashikuara në ligjin e cituar më sipër, me shkresat e datës 27.11.2013 dhe 09.01.2014 i kemi kërkuar Ministrit të Punëve Brendshme informacion lidhur me përgatitjen (hartimin) nga grupi i punës të akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005. Mirëpo edhe pas kërkesës tonë të përsëritur, nuk na u dërgua informacioni i kërkuar.

Në vijim të ndjekjes së problematikës mbi fenomenin shqetësues të gjakmarrjes, me shkresën tonë nr. K2/I37-9 Prot., datë 07.02.2014 i rekomanduam Ministrit të Punëve të Brendshme si më poshtë:

“1. Marrjen e masave të nevojshme në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.136, datë 14.11.2012 për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore në bazë të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”.

2. Hartimin (përgatitjen) sa më shpejt të akteve nënligjore të citura më sipër nga grupi ndërinstitucional i punës dhe dërgimin e tyre për miratim në Këshillin e Ministrave”.

Ministri i Punëve të Brendshme me shkresën nr. 3430 Prot., datë 22.09.2014 na informoi se, ka filluar puna për ngritjen e Sekretariatit Teknik në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”.

Meqenëse kaluan disa muaj nga dërgimi i përgjigjes së cituar më sipër dhe ende nuk kishim asnjë informacion për ecurinë e këtij problemi, me shkresat nr. K2/I37-23 Prot., datë 24.03.2015 dhe K2/I37-27 Prot., datë 19.05.2015, i kërkuam Ministrit të Punëve të Brendshme të dërgonte informacion lidhur me ngritjen e Sekretariatit Teknik dhe procesin e hartimit të akteve nënligjore të parashikuara në ligjin nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin

e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” dhe në Urdhrin e Kryeministrit nr.136, datë 14.11.2012.

Ministri i Punëve të Brendshme me shkresën nr. 4008/1 Prot., datë 09.06.2015, ndërmjet të tjerave na informoi se citojmë:

“Ministria e Punëve të Brendshme e ka të vështirë të realizojë e vetme një proces në të cilin përfshihen disa institucione.

Mosfunksionimi i Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes është një problematikë e cila lidhet direkt me moszbatimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”.

Për sa më sipër mendojmë se duhet të propozohen amendimet e nevojshme ligjore të këtij ligji për zgjidhjen e kësaj situatë”.

Zoti Kryeministër,

Sikurse përshkruam më lart, rezulton se gjakmarrja në vendin tonë është kthyer në një fenomen shqetësues si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Ne kemi bindjen e plotë se miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë i ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” dhe qëllimi i këtij ligji janë për tu vlerësuar si një hap pozitiv për ta luftuar këtë fenomen.

Ndërkohë theksojmë se, moszbatimi i këtij ligji, mosnxjerrja e miratimi i 3 akteve nënligjore në bazë e për zbatimin e tij dhe mosfunksionimi i Këshillit Koordinues për këtë çështje për vite me radhë tregon se fenomeni nuk është adresuar si duhet nga institucionet shtetërore, lidhur me parandalimin dhe zhdukjen e tij. Këto shqetësime janë pasqyruar edhe në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri miratuar në datën 05.03.2015.

Përgjigjia e fundit e Ministrit të Punëve të Brendshme, të cilën e cituam më lart, nuk flet për angazhim serioz të këtij institucioni për të zbatuar Urdhrin e Kryeministrit nr. 136, datë 14.11.2012 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”, i cili kryesohet nga Zëvendësministri i Punëve të Brendshme.

Ne mendojmë se, nëse nga institucionet e përfshira në këtë ligj gjykohet dhe vlerësohet se për zgjidhjen e kësaj situatë duhet të propozohen amendimet e nevojshme ligjore të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005, përse nuk bëhen ato dhe kush i pengon. Ndërkohë vlerësojmë se kthimi i një përgjigjeje të tillë pas rreth dy vitesh dhe qëndrimi i mbajtur nga institucionet shtetërore duke mos e vënë në zbatim këtë ligj tregon se zgjidhja e problemit po sorollatet duke bërë e shkëmbyer shkresa ndërmjet institucioneve.

Për sa më sipër dhe me qëllim vënien në zbatim sa më shpejt të këtij ligji shumë të rëndësishëm për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë

rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në gërmën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes”.

Marrjen e masave të nevojshme në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” për përgatitjen dhe miratimin nga Këshilli i Ministrave të akteve nënligjore të parashikuara në nenet 4, 5 dhe 6 të këtij ligji.

Për masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar nga neni 22 i ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

Me respekt

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI